

Republika e Kosovës / Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Komuna e Gjakovës / Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
 IZLAZNE ARHIVE
 OUTPUT ARCHIVES
 IV/2 8559

Nr.Invi/Br.Inv. 01-01161
 Nr.faqes/Br.Sht./No.Pa. 1

Data/Datum/Date 30.05.2024

Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. /2024

Datë:30.05.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në dispozitat e Ligjit Nr. 05/L -081 për Energjinë , nenin 21 paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë.30.05.2024, pas diskutimeve lidhur më pikën e 9 të rendit të ditës: Kërkesa për Shfrytëzim-Servitut në pronën Publike me karakter rrugë Publike, për Zhvillim të Trasesë nën Tokësore për shtrirjen e rrjetit Elektro energjetik të tensionit të lartë, e miratoi këtë:

V e n d i m

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për dhënien në Shfrytëzim-Servitut në pronën Publike me karakter rrugë Publike, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A për Zhvillim të Trasesë nën-tokësore për shtrirjen e rrjetit elektro-energjetik të tensionit të lartë.
2. Shfrytëzimi dhe krijimi i servitutit në brezat e rrugëve publike lokale sipas trasesë për shtrirjen e rrjetit elektro energjetik të tensioni të lartë do të bëhet në këto parcela Kadastrale :
 - Parcela me numër P-70705076-00441-0 Z.K. Qerim (P.SH. Rrugë publike).
 - Parcela me numër P-70705005-00494-0 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-00718-2 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-00775-1 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-01330-0 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-01332-0 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-01333-0 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-01334-1 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
 - Parcela me numër P-70705005-01334-3 Z.K. Bec (P.SH. Rrugë publike) .
3. Lidhur me kohëzgjatjen e të drejtës së servitutit, e njëjta do të rregullohet sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë të drejtë.
4. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për zbatimin e këtij vendimi sipas shënimeve të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
6. **Vendimi iu dërgohet:**
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës